


## Shtojca nr. 1


### Udhëzues për regjistrimin paraprak on-line nga kandidatët fitues

1. Për të kryer regjistrimin online duhet të shkoni tek linku: <http://matura.akp.gov.al>;
2. Te faja e hapur do të keni pamjen e mëposhtme:



The screenshot shows the homepage of the National Agency for Examinations (AKP) for the National Matura. The header includes the AKP logo, the text 'MATURA SHETËRORE Agjensia Kombëtare e Provimeve', and the 'mash' logo for the Ministry of Education and Science. A navigation menu contains links for 'KRYESORE', 'MATURA', 'UDHËZIME DHE FORMULARË', 'PROGRAME ORIENTUESE', 'TESTE PËRGATITORE', and 'VITET MË PARË'. The main content area is titled 'FAQJA KRYESORE PËR MATURËN SHETËRORE' and includes instructions for candidates, a search bar, and a 'Regjistrohu ne fakultet' button.

3. Këtu duhet të klikoni te butoni : **“Regjistrohu në fakultet”** dhe do t’ju shfaqet pamja e mëposhtme:




The registration form contains the following fields and a button:

- ID e Maturantit
- Emri
- Atësia
- Mbiemri
- Karte Identiteti - *Shembull*
- Email i Maturantit
- Identifikohu

4. Te fushat e shfaqura duhet të plotësohen me kujdes të dhënat e kërkuara. Në fushën **“Kartë Identitetit”** duhet të vendoset **numri personal** (kliko mbi fjalën shembull dhe do të shfaqet një kartë identiteti ilustruese). Numri personal , i kornizuar si më poshtë, gjendet në pjesën e poshtme, djathtas saj).



|   |  |
|---|--|
| ID e Maturantit                             | <input type="text"/>   |
| Emri  | <input type="text"/>   |
| Atësia                                      | <input type="text"/>   |
| Mbiemri                                     | <input type="text"/>   |
| Karte Identiteti<br>- Shembull              |  |
| Email i Maturantit                          | <input type="text"/>   |
| <input type="button" value="Identifikohu"/> |  |

- Duhet bërë kujdes që të plotësohen të gjithat fushat dhe informacioni në to të jetë i saktë. Pas plotësimit klikoni te butoni: “**Identifikohu**”.
- Nëse të dhënat tuaja nuk janë të sakta do të shfaqet mesazhi i mëposhtëm:

**Te dhenat qe futet jane te pasakta. Saktësoni te dhenat ose paraqituni per regjistrim prane sekretarise se fakultetit perkates.**

Kjo do të thotë se për të bërë regjistrimin e fazës së parë ju duhet të paraqiteni detyrimisht pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit në Universitetin ku jeni shpallur fitues me dokumentin tuaj personal të identifikimit.

- Nëse të dhënat tuaja janë të sakta do të vazhdoni procedurat e regjistrimit on-line sipas hapave të mëposhtme. Dritarja e mëposhtme shfaqet në ekran.



|            |            |                 |                            |
|------------|------------|-----------------|----------------------------|
| Emri       | Ermirela   | Vendlindja      | DURRËS                     |
| Atësia     | Hasan      | Shkolla e Mesme | (526) BESNIK HIDRI, DURRËS |
| Mbiemri    | Kota       | Profili         | GJIMNAZI 2012              |
| Gjinia     | Femër      |                 |                            |
| Datelindja | 27/06/1993 |                 |                            |

**Preferenca ne te cilen jeni shpallur fitues:**

|                      |                                     |
|----------------------|-------------------------------------|
| Universiteti:        | <b>UNIVERSITETI I TIRANËS</b>       |
| Fakulteti:           | <b>FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA</b> |
| Programi i studimit: | <b>Gjuhë Gjermane</b>               |
| Preferenca:          | <b>8</b>                            |
| Piket:               | <b>8700</b>                         |

Informacioni i mësipërm do të jenë të dhënat tuaja personale, të cilat plotësohen automatikisht nga sistemi pas konsultimit me bazën e të dhënave.

8. Për t'u regjistruar në fakultet, në fazën e parë, duhet të klikoni butonin: **“Regjistrohu”**. Pasi klikoni te ky buton në adresën tuaj të email-it do t'ju dërgohet një mesazh konfirmues, i cili ju njofton se jeni regjistruar tek programi i studimit në të cilin jeni shpallur fitues. Më pas do t'ju shfaqet pamja e mëposhtme:



Regjistrimi u krye me sukses

Do të vazhdoni konkurrimin për preferencat më të larta, apo konfirmoni regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar?

Vazhdoj konkurrimin për një preferencë më të lartë  Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar

[Ruaj](#) [Dil nga faqja](#)

| Preferenca | Program Studimi                   | Piket    |
|------------|-----------------------------------|----------|
| 1          | Gjuhë Spanjolle                   | 1,500.00 |
| 2          | Gjuhë Ruse                        | 2,500.00 |
| 3          | Menaxhim Hotel Restorant          | 3,500.00 |
| 4          | Financë – Kontabilitet            | 4,500.00 |
| 5          | Gjuhë Angleze                     | 5,500.00 |
| 6          | Administrim - Biznes              | 6,500.00 |
| 7          | Inxhinieri Agrare - Agromekanizim | 7,500.00 |
| 8          | Gjuhë Gjermane                    | 8,700.00 |
| 9          | Gjuhë Frënge                      | 9,500.00 |
| 10         | Shkencat e Lëvizjes               | 8,800.00 |

9. Nëse jeni shpallur fitues të një preferencë e ndryshme nga preferenca e parë dhe dëshironi të regjistroheni në mënyrë përfundimtare aty, pra të mos vazhdoni konkurrimin për një preferencë më të lartë, duhet të zgjidhni (klikoni) opsionin: **“Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar”** dhe më pas të klikoni tek butoni: **“Ruaj”**.
10. Nëse doni të vazhdoni konkurrimin për preferencat më të larta zgjidhni (klikoni) opsionin: **“Vazhdoj konkurrimin për një preferencë më të lartë”** dhe klikoni butonin: **“Ruaj”**  
Pasi të klikoni te butoni **“Ruaj”** do t'ju shfaqet mesazhi **“Veprimi u krye me sukses”** dhe pas kësaj mund të dilni nga faqja dhe të mbyllni browserin e internetit.
11. Sjellim në vëmendje, veprimi i regjistrimit on-line lejohet të kryhet vetëm njëherë.
12. Studenti/ja, gjatë javës së parë të frekuentimit të studimeve universitare në programin e studimit ku është shpallur fitues, dorëzon pranë sekretarisë mësimore të fakultetit përkatës, dokumentet plotësuese të mëposhtëm:
  - a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e njërit prej dokumenteve të identifikimit (e panoterizuar);
  - b) 2 fotografi;
  - c) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekësh, paguar pranë zyrave të postës shqiptare, për llogari të IALP-së përkatëse.